

VENDIM
Nr. 736, datë 23.11.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 783, DATË 15.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, NYJA TEG’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 783, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 64 499 504 (gjashtëdhjetë e katër milionë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e katër) lekë ...” zëvendësohet me “... 66 420 087 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e njëzet mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë ...”;

b) Në pikën 5, vlera “... 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë ...” zëvendësohet me “... 100 000 (njëqind mijë) lekë ...”;

c) Të dhënat për nënndarjet me numrat rendorë 3 dhe 4, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në seksionin A, si dhe shtohen nënndarjet për pasuritë me nr. 583/34, nr. 583/21, nr. 484/10, nr. 484/6/1, nr. 484/7 dhe nr. 484/17, me të dhënat në seksionin B, të tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1 dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, PASURITË E PALUAJTSHME TË TË CILËVE PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 783, DATË 15.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, NYJA TEG’”.

Tabela që pasqyron ndryshimet dhe shtesën e bëra në tabelën bashkëlidhur VKM-në nr. 783, datë 15.12.2021.

Të dhënat sipas VKM-së nr. 783, datë 15.12.2021		Të dhënat e ndryshuara dhe shtesa											
Nr.	Nr. rendor në VKM-në nr. 783, datë 15.12.2021	Numri i pasurisë	Emër/atësi/mbiemër	Sip. totale m ²	Lloji i pasurisë	TOKË TRUALL			TOKË ARË			Vlera totale (lek)	Shënime
						Sipërfaqja e shpronësimit (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera, lek	Sip. e shpronësimit (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera, lek		
Seksioni A që pasqyron pasurinë që ndryshohet në tabelën bashkëlidhur VKM-së nr. 783, datë 15.12.2021													
1	3	583/13	Besart Avni Shehu Iva Arben Shehu	4635	ARE			0.00	245	523.00	128,135.00	128,135	
2	4	583/24	Theofilos Fuat Alimeta Arben Avni Paja Petrît Avni	4000	ARE + TRUALL			0.00	204	523.00	106,692.00	106,692	
Seksioni B që pasqyron pasurinë që shtohet në tabelën bashkëlidhur VKM-së nr. 783, datë 15.12.2021													
3		583/34	Lazam Isak Doda	1000	TRUALL	135	3283.00	443,205.00		0.00		443,205	
4		583/21	Lazam Isak Doda	8000	ARE			0.00	2282	523	1,193,486.00	1,193,486	
5		484/10	Refat Skender Shehu Bojken Skender Kola Tefia Haxhi Zekaj	6,800.00	ARE			0.00	493.50	523.00	258,100.50	258,101	
6		484/6/1	Arben Hysen Çala	2,000.00	ARE			0.00	136.50	523.00	71,389.50	71,390	Në favor të Arber Luarasi K. Qira
7		484/7	Arben Hysen Çala	2,000.00	TRUALL	84.50	3,283.00	277,413.50			0.00	277,414	Në favor të B.K. Greçiqë për shumën 100,000 euro
8		484/17	Shoqëria "Megapharma" sh.p.k.	2,000.00	truall	55.50	3,283.00	182,206.50			0.00	182,207	Vendoset hipotekë ligjore në favor të banka OTP Albania sh.a. për shumën 1,500,000 euro
Vlera totale (lek)												2,660,628.00	